



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1684, datë 14.09.2011

Për

“Miratimin e Termave të References për dokumentin e tenderit për prokurimin me objekt “Konsulencë Ndërkombëtare për Përgatitjen e Dokumentave të Analizave të Tregut në Sektorin e Komunikimeve Elektronike në RSH”“

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 14.09.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, mori në shqyrtim materialet shkresore të paraqitura nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhërin Nr.696, date 06.05.2011 “ Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Termave të Referencës lidhur me Dokumentet e tenderit për prokurimin me objekt “Konsulencë Ndërkombëtare për Analizën e Tregut”” të përbëra nga:

- Termat e References për dokumentin e tenderit për prokurimin me objekt “Konsulencë Ndërkombëtare për Përgatitjen e Dokumentave të Analizave të Tregut në Sektorin e Komunikimeve Elektronike në RSH“ (**Dokumenti**),
- relacionin përkatës (**relacioni**);
- Projektvendim i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485” (**Projektvendimi**).

BAZA LIGJORE:

1. Neni 31 e nenet në vijim të Kreut VI, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 të ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
2. Neni 106 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar (*ligji nr. 8485*);
3. Ligj nr. 9643, datë 20.11.2006 “ Për prokurimin publik”, i ndryshuar (*Ligj nr. 9643*)
4. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (*VKM Nr. 1*);
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24.04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
6. Urdher i Kryetarit nr. 696, date 06.05.2011 “ Per ngritjen e grupit te punes per hartimin e Termave te Refernces lidhur me Dokumentet e tenderit per prokurimin me objekt “Konsulence Nderkombetare per Analizen e Tregut”” (*Urdher nr. 696*)

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, diskutimeve në mbledhje, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V Ë R E N:

1. Dokumenti është hartuar nga grupi i punës në zbatim të Urdhërit Nr. 696;
2. Nga pikpamja formale procedurale, dokumenti është trajtuar nga grupi i punës në përputhje me përcaktimet ligjore të parashikuara në legjislacionin për prokurimin publik sipas dispozitave të përcaktuara në pikën 2 dhe 3 të Bazës ligjore të këtij akti administrativ;
3. Nga pikpamja substanciale, dokumenti përmban terma referencë në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, ligjin nr. 9918 lidhur me Analizën e Tregut, si dhe aktet nënligjore dhe administrative normative të përcaktuara në bazën ligjore të mësipërcituar;
4. Projektvendimi është në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në nenin 87, 88, pikën 1 të nenit 114, pikën 1 të nenin 115 të ligjit nr. 9918 dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Të miratojë “Termat e References për dokumentin e tenderit për prokurimin me objekt *“Konsulencë Ndërkombëtare për Përgatitjen e Dokumentave të Analizave të Tregut në Sektorin e Komunikimeve Elektronike në RSH”*, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. “Termat e References për dokumentin e tenderit për prokurimin me objekt *“Konsulencë Ndërkombëtare për Përgatitjen e Dokumentave të Analizave të Tregut në Sektorin e Komunikimeve Elektronike në RSH”* të miratuara me këtë vendim, të bëhen pjesë e Dokumentit Standart të tenderit publik që do të kryhet nga AKEP sipas procedurës së prokurimit të përcaktuar në ligjit nr. 9643 dhe VKM NR. 1.
3. Me fondin limit të përcaktuar për këtë qëllim në planin e detajuar të shpenzimeve të AKEP për vitin 2011, të fillojë procedura sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin për prokurimin publik, për kryerjen e tenderit për këtë qëllim.
4. Autorizohet Kryetari të zbatojë procedurën për kryerjen e tenderit.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Zamira NURCE**

TERMAT E REFERENCES

“Konsulencë Ndërkombëtare për Përgatitjen e Dokumentave të Analizave të Tregut në Sektorin e Komunikimeve Elektronike në RSH”

INFORMACION I PERGJITHSHEM

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, AKEP (më parë njohur si Enti Rregullator i Telekomunikacioneve) është autoriteti rregullator i komunikimeve elektronike me postare në Republikën e Shqipërisë, i cili vepron në baze të Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe mbikëqyr politikën e zhvillimit të telekomunikacioneve në Shqipëri.

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ky ligj, nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikën e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

AKEP-i është një person juridik, publik, jobuxhetor, i pavarur, i cili e zhvillon veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi. AKEP-i në punën dhe në marrjen e vendimeve Brenda kompetencave të tij është i pavarur. AKEP-i e ka selinë në Tiranë.

- Legjislacioni

Sektori i komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë rregullohet nëpërmjet ligjit nr.9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i cili ka si qëllim që, nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike, të promovojë konkurrencën dhe infrastrukturën efiçente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky ligj është në hartuar për ta përfunduar me paketën Rregullatore të BE-së në fushën e komunikimeve elektronike sipas direktivave 2002 të KE. Aktualisht MITIK është në proces amendimi për ta përfunduar me rekomandimet me të fundit të KE. Disa prej rregulloreve me të rëndësishme që kanë lidhje me rregullimin ex-ante janë:

- Rregullore për aksesin dhe interkoneksionin
- Rregullore për analizen e tregut
- Rregullore për portabilitetin e numrit
- Rregullore për C(P)S
- Rregullore për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe ose shërbimeve të komunikimeve elektronike etj.

Rregulloret e mesiperme janë të publikuara në faqen e Internetit të AKEP www.akep.al në gjuhën shqip dhe anglisht.

Numri i sipërmarrësve të cilët kanë njoftuar AKEP për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike deri në fund të vitit 2010 ishte 196 në krahasim me 152 në fund të vitit 2009. Referuar “Regjistrin të Sipërmarrësve” në lidhje me njoftimin për ofrim rrjetesh/shërbimesh gjendja në fund të vitit 2010, rezulton:

- Ofrim shërbimi publik telefonik të lëvizshëm – 4 sipërmarrës, sa në vitin 2009;
- Ofrim shërbimit publik telefonik fiks (të qëndrueshëm) – 82 sipërmarrës, kundrejt 73 në vitin 2009;
- Ofrim shërbimi të aksesit në Internet – 116 sipërmarrës, kundrejt 89 në vitin 2009;
- Ofrim shërbimi me vlerë të shtuar – 43 sipërmarrës, kundrejt 36 në vitin 2009;
- Ofrim të linjave me qera – 37 sipërmarrës, kundrejt 29 në vitin 2009.

Telefonia celulare

Në sektorin e telefonisë celulare janë lëshuar katër autorizime individuale (më parë licenca):

- AMC sh.a,
- Vodafone Albania, sh.a
- Eagle Mobile, sh.a
- Plus Communciations sh.a

Operatori AMC është licensuar si operator publik kombëtar i telefonisë celulare në vitin 1996 dhe ka funksionuar si kompani shtetërore deri në Shtator të vitit 2000, kur u krye privatizimi i 85 % të aksioneve.

Operatori Vodafone Albania është licensuar si operatori i dytë kombëtar i shërbimit celular GSM në Shqipëri më 9 Qershor 2001.

Operatori “Eagle Mobile” është licensuar si operatori i tretë kombëtar i shërbimit celular GSM në Shqipëri më 1 Mars 2004. Licenca iu dha Albtelcom-it si pjesë e paketës së privatizimit të kësaj kompanie, proces i cili përfundoi në vitin 2007. Operatori Eagle Mobile filloi ofrimin e shërbimeve celulare në Mars 2008.

Operatori Plus Communciations është operatori i katërt celular GSM, të cilit iu akordua autorizimi individual nga AKEP-i me datë 26.06.2009. Ka filluar ofrimin e shërbimeve në fund të vitit 2010.

Në fund të vitit 2010, numri i përdoruesve të telefonisë së lëvizshme arriti në afërsisht 4.5 milion, e cila përbën një normë penetrimi (numri i përdoruesve për 100 banorë) prej 140%¹. Norma vjetore e rritjes së numrit të përdoruesve ishte rreth 9% (rreth 360 mijë përdorues më shumë), që është shumë më e ulët se norma e rritjes vjetore prej 41% në vitin 2009 apo dhe me vitet e mëparshme. Rënia e normës së rritjes si dhe numri i lartë i përdoruesve për 100 banorë përbëjnë shenja se ky treg po i afrohet fazës së saturimit. Gjatë vitit 2010 rritje më të madhe ka pasur Eagle Mobile me 37% ndërsa AMC me 6%, ndërkohë që numri i përdoruesve të Vodafone është rritur në masë shumë të vogël. Përdoruesit me parapagim vazhdojnë të përbëjnë më shumë se 90% të përdoruesve celulare dhe kjo strukturë abonentësh është e ngjashme në të katër operatorët.

¹ Numri i përdoruesve celularë i referohet numrit të kartave SIM aktive, dhe normat e larta të përdoruesve për 100 banorë shpjegohen nga mbajtja prej një individi e më shumë se 1 kartë SIM si dhe prej përdorimit të kartave SIM nga vizitorët në një vend.

Struktura e perdoruesve celulare, ne perdorues me parapagim dhe me pas-pagim (kontrate), vazhdon te jete e qendrueshme dhe ne vitin 2010, ku numri i perdoruesve me kontrate ne raport me numrin total te perdoruesve celulare, eshte afersisht 8%. Struktura e perdoruesve eshte e ngjashme te te kater operatoret celulare, megjithese Eagle Mobile ka rreth 12% te perdoruesve me kontrate ndersa me pak ka Plus qe ka rreth 5% te perdoruesve me kontrate. Me 1.07.2011 numri i perdoruesve te telefonise se levizshme arriti ne 4.75 milion ndersa pjeset e tregut te operatoreve celulare per numrin e perdoruesve ishin: AMC 40%; Vodafone Albania 35%, Eagle Mobile 20% dhe Plus Communication 5%.

- Telefonia fikse

Telefonia fikse ne ndryshim nga telefonia celulare dhe Interneti, ka pesuar ndryshime shume te vogla ne numrin e pajtimtarëve, dhe vazhdon te ketë një penetrim shume te ulët. Ne fund te vitit 2010, numri i pajtimtarëve te telefonise fikse arriti ne rreth 332 mijë, nivel i cili perben një reduktim ne krahasim me 338 mijë qe ishin ne fund te vitit 2009. Ky reduktim erdhi si rezultat i reduktimit te numrit te pajtimtarëve te Albtelecom me rreth 15 mijë abonente apo 5% te numrit total, qe perben një tendencë te kundërt me rritjen e madhe ne vitin 2009, (rritja me madhe ne vitet e fundit). Nderkohë ne këtë periudhë ka një rritje te ndjeshme te numrit te pajtimtarëve nga operatorët alteranativë me rreth 8 mijë pajtimtarë: nga 45 mijë ne fund te vitit 2009 ne 53 mijë ne fund te vitit 2010. Kjo tregon se gjate vitit 2010, ka pasur kalim te pajtimtarëve te Albtelecom tek operatorët alternative qe tregon se operatorët alternativë kanë arritur te konkurrojnë me Albtelecom ne terma te cmimeve dhe cilësisë se shërbimeve. Norma e penetrimit te telefonise fikse ne fund te vitit 2010, ishte 10.2%, qe perben një normë shume te ulët ne krahasim me vendet e BE (me një mesatare rreth 45%) dhe vendet e rajonit. Megjithë rënien e numrit te pajtimtarëve ne vitin 2010, Albtelecom zotëronte rreth 84% te këtij tregu me rreth 278 mijë pajtimtarë ndersa operatorët alternativë rreth 16% me rreth 53 mijë pajtimtarë. Ne gjashtemujorin e pare te vitit 2011 numri total i pajtimtarëve te telefonise fikse ishte 329 mijë eshte vere nje reduktim i numrit te pajtimtarëve te Albtelecom dhe rritje e numrit te pajtimtarëve te operatoreve alternative, duke rezultuar ne 81% pjese tregu per Albtelecom dhe 19% pjese tregu per OA.

Operatorët alternativë kanë zgjeruar zonat e tyre te operimit dhe janë te perqendruar kryesisht ne zonat me urbane dhe zonat rurale ne afërsi te qyteteve. Struktura dhe niveli i tarifave te këtyre operatorëve është i ngjashëm me ato te Albtelecom. Një numër operatorësh alternativë ofrojnë njëkohësisht shërbime te telefonise fikse, akses ne Internet dhe TV. Operatorët alternative kane ofruar paketa dyfishe dhe tre-fishe (internet, telefoni dhe TV).

Interneti

Sipas te dhënave dhe vlerësimeve te AKEP deri ne fund te vitit 2010 numri i familjeve qe kanë akses ne Internet me bandë te gjerë (broadband) është rreth 110 mijë apo afërsisht 13.7% e familjeve, ndersa vlerësohen te jenë mbi 10.000 pajtimtarë biznesi. Bazuar ne këto te dhëna, numri i linjave broadband per 100 banore është rreth 3.7%, krahasuar me 2.5% qe ishte ne fund te vitit 2009. Ne gjashtemujorin e pare te vitit 2011 numri i familjeve me akses broadband velresohet te kete arritur ne rreth 130 mijë, ku rritje me te madhe kane operatoret alternative.

Ndarja e tregut per ofruesit e shërbimit te Internetit, ndërmjet Albtelecom dhe ofruesve te tjerë te këtij shërbimi, rezulton qe Albtelecom zotëron rreth 59% pjese tregu per numrin e pajtimtarëve.

Numri i pajtimtarëve (lidhjeve) broadband nëpërmjet ADSL të Albtelecom, deri në fund vitit 2010 është rreth 70 mijë pajtimtarë nga të cilët rreth 6% të tyre janë pajtimtarë biznes, kurse të tjerët janë pajtimtarë familjare. Gjatë vitit 2010 numri i pajtimtarëve me akses broadband në Internet të Albtelecom, është rritur me rreth 20 mijë apo 35% krahasuar me fundin e vitit 2009.

Teknologjia kryesore vazhdon të jetë ADSL dhe operatori kryesor është Albtelecom, i cili ka qenë shumë aktiv në shërbimet e aksesit në Internet, nëpërmjet investimeve në rrjetin lokal për të mundësuar ofrimin e shërbimit broadband nëpërmjet ADSL dhe reduktimit të tarifave për këtë shërbim. Nga të dhënat vihet re se një numër i konsiderueshëm i lidhjeve broadband nga operatorët alternativë kryhet me kombinim fibër optike, kabëll koaksial apo linjë bakri. Ndërkohe rreth 87% e abonenteve ADSL të Albtelecom përfitojnë akses në Internet me MSAN ku lidhja nga centrali telefonik deri në kabinet është me fibër optike dhe më pas me linjë bakri, e cila mund të konsiderohet si FTTN (Fiber To The Node).

Krahasimi i të dhënave të përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike me vendet e BE për vitin 2010, tregon se Shqipëria ka norme me të lartë penetrimi të shërbimeve celulare se mesterja e vendeve të BE (140% v 122%), por norme shumë me të ulët penetrimi në telefoni fikse (10% v 40%) dhe akses internet broadband (3.7% v 25%).

Të ardhurat totale të sipërmarrësve për vitin 2010 ishin 57087 milion lek të cilat përbejnë një reduktim prej 7.2% në krahasim me vitin 2009 kur të ardhurat ishin 61578 milion LEK. Kater operatorët celulare dhe Albtelecom, zoterojnë rreth 92% të ardhurave të gjithë sektorit (reduktim nga niveli 95% në 2009), ndërsa operatorët e tjerë (Operatorët Alternative) zoterojnë rreth 8% pjesë tregu (rritje nga niveli 5% në 2009). Të ardhurat e operatorëve celulare përbëjnë 73% të të ardhurave të të gjithë tregut (reduktim nga 77% e 2009), ndërsa operatori fikse Albtelecom zotëron 19% (rritje nga 18% në 2009).

Analizat e Tregjeve

AKEP ka kryer disa runde të analizave të tregut duke filluar nga viti 2006. AKEP, në përputhje me përcaktimet e ligjit 9918, dhe Rregullores së Analizës së Tregut, miratuar nga AKEP, me VKD nr.747 datë.17.07.2009, gjatë vitit 2010 miratoi versionet finale dhe vendimet për FNT në tregjet celulare dhe të telefonisë fikse si dhe gjatë vitit 2011 miratoi versionet finale dhe vendimet për FNT për tregjet me shumicë broadband dhe linjave me qera.

a) Më datë 31.03.2010, u publikua versioni final i analizës së tregut të telefonisë së lëvizshme², e cila përmban analizën e tregjeve nr.8, nr.16 dhe nr.17, të Rregullores së Analizës së Tregut (apo tregjet nr. 15 dhe 16 të Rekomandimit të KE (2003/311/EC) si dhe tregun me pakicë celular):

- Tregu me pakicë të aksesit dhe shërbimeve nëpërmjet rrjeteve mobile.
- Tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale të lëvizshme;

- Tregu me shumicë të aksesit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike të lëvizshme

AKEP me vendimet nr.1210, 1211 dhe 1212, datë 31.03.2010, përcaktoi sipërmarrësit me FNT:

- AMC sh.a në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin AMC dhe në tregun me shumicë të akses/origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare;
- Vodafone Albania në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin Vodafone Albania dhe në tregun me shumicë të akses/origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare;
- Eagle Mobile në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin Eagle Mobile.

Nëpërmjet këtyre vendimeve u përcaktuan dhe masat rregulluese (detyrimet) për sipërmarrësit me FNT në tregjet përkatës, të tilla si detyrimet e transparencës, mosdiskriminimit, dhënie akses dhe orientimit në kosto të tarifave. Detyrimet për terminimin e thirrjeve për të tre operatorët janë të njëjta dhe përfshijnë të gjitha detyrimet e përcaktuara në ligjin 9918, ndërsa për origjinimin e thirrjeve për AMC dhe Vodafone Albania, detyrimet për kontrollin e tarifës u vendosën për thirrjet drejt numrave 0800 dhe numrave të aksesit për platformat e kartave me parapagim.

Nga analiza e tregut, AKEP konkludoi se tregu celular me pakicë (tregu nr.8 në Rregulloren e Analizës së Tregut) nuk ishte më treg i justifikueshëm për ndërhyrje ex-ante, dhe për rrjedhim vendosi të hiqte detyrimet për këtë treg ndaj Vodafone Albania dhe AMC. Heqja e detyrimeve u bë efektive më 1.07.2010.

b) Më datë 26.07.2010, AKEP publikoi analizën finale të tregut të telefonisë fikse, që përmban analizën e tregjeve nr.1-6 dhe 9-11 të Rregullores së Analizës së Tregut:

- Tregu me pakicë i aksesit në rrjet telefonik publik nga vendndodhje fikse për klientet familjarë;
- Tregu me pakicë i aksesit në rrjet telefonik publik nga vendndodhje fikse për klientet jo-familjarë;
- Tregu me pakicë për thirrjet lokale dhe/ose kombëtare të disponueshme për publikun të ofruar nga vendndodhje fikse për klientet familjarë.
- Tregu me pakicë për thirrjet telefonike ndërkombëtare të disponueshme për publikun të ofruara nga vendndodhje fikse për klientet familjarë.
- Tregu me pakicë për thirrjet lokale dhe/ose kombëtare të disponueshme për publikun të ofruar nga vendndodhje fikse për klientet jo-familjare.
- Tregu me pakicë për thirrjet ndërkombëtare të disponueshme për publikun të ofruara nga vendndodhje fikse për klientet jo-familjarë.
- Tregu me shumicë i origjinimit të thirrjeve në rrjetin telefonik publik të ofruar nga vendndodhje fikse .
- Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve për rrjete publike telefonike individuale të ofruara nga vendndodhje fikse
- Tregu me shumicë i shërbimeve transite në rrjetet telefonike publike fikse.

Bazuar në këtë analizë tregu me vendimin nr.1348, datë 26.07.2010, AKEP përcaktoi Albtelcom me FNT në tregjet përkatës të mësipërm duke vendosur detyrimet për transparencën,

mosdiskriminimin, kontrollin e tarifave dhe orientimin në kosto, dhe dhënien akses për zgjedhje/parazgjedhje të bartësit. AKEP përcaktoi që zbatimi i detyrimeve të orientimit në kosto të tarifave të interkoneksionit, përfshirë ribalancimin e plotë të tarifave të pajtimtarëve të Albtelecom dhe detyrimet për zgjedhjen/parazgjedhjen e bartësit, do të kryhet në bazë të përcaktimeve të ardhshme të AKEP, nëpërmjet një vendimi që do të merret bazuar në rezultatet e modelit BULRIAC të përfunduar në muajin Korrik 2010. Për këtë do të kryhet një konsultim publik me të gjitha palët e interesuara, proces që konsiderohet shumë i rëndësishëm nga AKEP për shkak edhe të efekteve sociale që mund të ketë ndryshimi i tarifave me pakicë për orientimin në kosto të tyre.

c) Më datë 13.04.2011 AKEP publikoi versionin final të analizës së tregjeve me shumicë të shërbimeve të aksesit broadband, që përmbajnë analizat e tregjeve nr.14 dhe 15, të Rregullores së Analizës së Tregut:

- Tregun me shumicë të aksesit në infrastrukturen e rrjeteve fizike (përfshirë aksesin e ndarë të pjesshëm ose të plotë) nga vendodhje fikse.
- Tregun me shumicë të aksesit broadband .

Bazuar në këtë analizë tregu me vendimin nr.1565, datë 13.04.2011, AKEP përcaktoi Albtelecom me FNT në tregjet përkatës të mësipërm duke vendosur detyrimet për transparencën, mosdiskriminimin, kontrollin e tarifave dhe orientimin në kosto, përfshirë publikimin e RUO. Aktualisht keto detyrime nuk janë bërë efektive akoma.

d) Më 13.04.2011 AKEP publikoi versionin final të analizës së tregjeve me pakicë dhe me shumicë të linjave me qera³, apo tregjet nr.7, 12 dhe 13 të Rregullores së Analizës së tregut (apo tregjet nr.7, 13 dhe 14 të Rekomandimit të KE (2003/311/EC) dhe konkretisht:

- Tregu me pakicë i minimumit të linjave me qera (i cili përfshin lloje të specifikuar të linjave me qera deri në 2Mb/sek)
- Tregu me shumicë i segmenteve terminuese të linjave me qera;
- Tregu me shumicë i linjave kryesore (trunk) të linjave me qera;

Bazuar në këtë analizë tregu me vendimin nr.1564, datë 13.04.2011, AKEP përcaktoi Albtelecom me FNT në tregjet përkatës të mësipërm duke vendosur detyrimet për transparencën, mosdiskriminimin, kontrollin e tarifave dhe orientimin në kosto.

e) Me datë 5.07.2011, AKEP publikoi për konsultim publik Analizën e tregut të terminimit të mesazheve SMS në rrjetet individuale celulare. Versioni final i analizës dhe vendimet për FNT janë në proces.

Nje permbledhje e operatoreve me FNT dhe masave rregulluese te vendosura me keto analiza dhe qe jane aktualisht ne fuqi eshte dhene ne tabelen e meposhteme.

Tregje te pakices dhe shumices te analizuar nga AKEP	Referenca ne Listen e Tregjeve te Rregullores	Operatore me FNT	Detyrimet e vendosura per FNT	Referenca ligjore (Nr.vendime ve)
Tregu me shumice i terminimit te thirrjeve ne rrjetet individuale te levizshme.	Nr.17	AMC Vodafone Albania Eagle Mobile	<ul style="list-style-type: none"> • Mosdiskriminim RIO • Transparence • Akses dhe Interkoneksion • Kontroll cmimesh • Orientim ne kosto • 	VKD te AKEP 1210, 1211 dhe 1212 31.03.2010, te amenduara
Tregu me shumice i aksesit dhe origjinimit te thirrjeve ne rrjetet telefonike publike te levizshme	Nr.16	AMC Vodafone Albania	<ul style="list-style-type: none"> • Mosdiskriminim • RIO per sherbimin e origjinimit te thirrjeve te drejt numrave te opearatoreve me karta me parapagim si dhe thirrjet drejt numrave pa pagese 0800. • per kartat e parapaguar per thirrjet drejt numrave 0800 • Transparence • Akses dhe Interkoneksion • Kontroll cmimesh dhe Orientim ne kosto per sherbimin e origjinimit te thirrjeve te drejt numrave te opearatoreve me karta me parapagim si dhe thirrjet drejt numrave pa pagese 0800. • Ne terma komerciale per sherbimet e tjera te akses dhe origjinimit te thirrjeve perfshire MVNO 	VKD te AKEP me 1210 dhe 1211 me 31.03.2010, te amenduara
Tregu me pakice i sherbimeve celulare	Nr.8	Pa FNT	<ul style="list-style-type: none"> • Detyrimet e vendosura me pare (kontroll cmimesh per AMC dhe Vodafone) u hoqen me 1.07.2010 	VKD te AKEP me 1210 dhe 1211 me 31.03.2010, te amenduara
Tregjet me pakice per akses dhe thirrje telefonike(locale, kombetare dhe nderkombetare) nga vendodhje fikse per kategorine familjare dhe jo-familjare	Nr.1-6	Albtelecom	<ul style="list-style-type: none"> • Mosdiskriminim RIO • • Transparence • Akses dhe Interkoneksion 	VKD te AKEP 1348 me 26.07.2010, i amenduar .
Tregu me shumice i origjinimit te thirrjeve ne rrjetin telefonik publik te ofruara nga vendodhje fikse.	Nr.9	Albtelecom	<ul style="list-style-type: none"> • CS/CPS • Kontroll cmimesh • Orientim ne kosto 	

Tregje te pakices dhe shumices te analizuar nga AKEP	Referenca ne Listen e Tregjeve te Rregullores	Operatore me FNT	Detyrimet e vendosura per FNT	Referenca ligjore (Nr.vendimeve)
Tregu me shumice i terminimit te thirrjeve ne rrjete publike telefonike individuale te ofruara nga vendodhje fikse.	Nr.10	Albtelecom		
Tregu me shumice i tranzimit te thirrjeve ne rrjetet telefonike publike fikse.	Nr.11	Albtelecom		
Tregu i Linjave me Qira,ne nivel pakice dhe tregjet e nivelit te shumices (trank segmentet dhe Segmentet Terminuese),	Nr.7, 12, 13	Albtelecom	<ul style="list-style-type: none"> • Mosdiskriminim RIO • Transparence • Akses dhe Interkoneksion • Kontroll cmimesh • Orientim ne kosto 	VKD Nr. 1564 te AKEP me 13.04.2011
Tregjet e nivelit te shumices per Broadband dhe LLU	Nr.14 dhe 15	Albtelecom	<ul style="list-style-type: none"> • Mosdiskriminim (RUO) • Transparence • Akses dhe Interkoneksion • Kontroll cmimesh • Orientim ne kosto 	VKD Nr. 1565 te AKEP me 13.04.2011
Tregu me Shumice i terminimit te SMS-ve ne rrjetet individuale celulare (konsultim public 5.07-5.09.2011)	Jo pjese e listes	AMC Vodafone Albania EM PC	<ul style="list-style-type: none"> • Te propozuara: • Mosdiskriminim RIO • Transparence • Akses dhe Interkoneksion • Kontroll cmimesh • Orientim ne kosto 	Vendimet per FNT jane ne process vendim-marrje

Përcaktimi i Kostos së Ofrit të Shërbimeve nga Operatorët me FNT

Në vijim të kontratave të nënshkruara në vitin 2009, me dy kompani konsulencë ndërkombëtare për përlogjartjen e kostove të shërbimeve të telefonisë fikse dhe celulare nëpërmjet metodës së kostos inkrementale afatgjatë (BU-LRAIC), AKEP gjatë vitit 2010 u përqendrua në zhvillimin e dy modeleve, te cilat perfunduan ne muajin Korrik 2010.

Në vijim të mbylljes së projektit të kostove BULRAIC për telefoninë celulare, AKEP me vendimet 1055-1058, datë 10.02.2011, vendosi që tarifat e terminimit dhe të origjinimit per operatoret me FNT ne treg, te jene te orientuara ne kostot BULRAIC dhe të rregullohen me reduktim të përshkallëzuar ne periudhen 2011-2013.

AKEP, bazuar në rezultatet e modelit BULARIC për Altelecom, është duke përgatitur një dokument për orientimin në kosto të tarifave me shumicë dhe me pakicë të Altelecom. Ky dokument do t'i nënshtrohet konsultimit publik dhe AKEP do të marrë më pas vendime për orientimin në kostot BULRAIC të tarifave me shumicë të Altelecom dhe ribalancimin e plotë të tarifave me pakicë.

Në lidhje me aksesin dhe interkoneksionin, operatorët me FNT kanë detyrimin dhe kanë publikuar ofertat refernce të interkoneksionit si dhe janë në fuqi rregulloret e mëposhteme:

- Rregullore nr.19, date 14.06.2010 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin” (e cila zëvendësoi rregulloren e mëparshme miratuar në Dhjetor 2007).
- Rregullore nr. 18, date 11.06.2010 ”Për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”

Objekti dhe qellimi i konsulences nderkombetare per analizen e tregut:

Qellimi eshte zhvillimi i nje raundi te plote analizash tregu per te gjitha tregjet te cilat jane ne listen e tregjeve te rekomanduara nga BE, por edhe te perfshira ne listen e tregjeve e cila eshte e perfshire ne Neni 3, i Rregullores se Analizes se Tregut, miratuar me VKD Nr.747 date 17.07.2009.

Konsulenti kerkohet te zhvilloje nje raund te plote te analizave per 18 tregjet e listuara ne kete liste, duke i zhvilluar ato ne perputhje te plote me percaktimet e ligjit 9918, "Per Komunikimet Elektronike ne RSH", percaktimet e Rregullores per Analizen e Tregut, duke marrë në konsiderate rekomandimet e KE dhe praktikat me te mira nderkombetare.

Objekti: Konsulence nderkombetare per kryerjen e analizave te tregjeve të justifikuar per nderhyrje ex-ante ne sektorin e komunikimeve elektronike ne RSH.

Synimi : AKEP synon qe outputet e konsulences nderkombetare ti perdore si inpute ne procesin e vendim-marrjes per zhvillimin e procedurave te analizave te tregjeve, percaktimin me FNT dhe vendosjen, ndryshimin, mbajtjen ose heqjen e detyrimeve (masave rregullatore) për FNT si dhe te permiresoje kapacitetet aktuale te AKEP nepermjet trajnimit te tyre per rregullimin ex-ante dhe kryerjen e procedurave te analizave te tregjeve ne perputhje me kuadrin rregullator te Komisionit European per komunikimet elektronike.

Objektivi i pergjithshem

I projektit eshte maksimizimi i perfitimeve te perdoruesve fundore ne perdorimin e sherbimeve te komunikimeve elektronike nepermjet nxitjes se konkurrencës së qëndrueshme ne sektorin e komunikimeve elektronike ne RSH.

Rezultatet qe pritet te arrihen nga Konsulenti:

Rezultatet qe priten nga konsulenti nderkombetar jane:

- Pergatitja e dokumentacionit te plote per zhvillimin e procedurave te analizave te tregjeve qe perfshin:
 - o Perkufizimin e tregjeve perkates te justifikuar per nderhyrje ex-ante sipas rrethanave dhe kushteve te tregut ne Shqiperi duke marrë në konsiderate rekomandimet e KE dhe pervojen ne tregjet e vendeve te BE. Detajet per listen e tregjeve jane dhene ne specifikimin e detyrave me poshte.
 - o Analizat e tregjeve per FNT dhe percaktimin e sipermarresve me FNT per tregjet e percaktuara te justifikuar per nderhyrje ex-ante gjate projektit.
 - o vendosjen, ndryshimin, mbajtjen ose heqjen e detyrimeve (masave rregullatore) për FNT per te gjitha tregjet e analizuara;

- hartimin e pyetsoreve per mbledhjen e te dhenave shtese (pervec atyre qe zoteron dhe mbledh AKEP) qe konsiderohen te nevojshme nga konsulenti per zhvillimin e analizave te tregjeve.
- Pergatitjen e dokumentave per konsultim publik, pergjigje ndaj komenteve dhe dokumentat final te analizave te tregjeve.
- Asistence per AKEP ne trajtimin e ankimeve administrative dhe procedurave gjyqesore ⁴nese ka te tilla me operatoret e percaktuar me FNT ne baze te analizave te kryera nga konsulenti.
- Trajnim te stafit te AKEP ne ambientet e AKEP gjate gjithe fazave te projektit.

⁴ Nese procese te tilla ndodhin pas mbarimit te projektit, asistenca mund te jepet me komunikim elektronik me AKEP.

Pershkrimi dhe Kërkesa specifike te projektit:

I- Raporti Paraprak (Inception Report) dhe Planifikimi Strategjik

Puna e konsulentit do të fillojë me përgatitjen e Raportit Paraprak dhe Plani I Veprimit. Në këtë fazë, konsulenti do të:

- a. kryejë një analizë të përgjithshme të situatës në sektorin e komunikimeve elektronike në RSH, duke u fokusuar në faktorët ekonomike, teknike, ligjor dhe rregullator që janë të rëndësishme për rregullimin ex-ante (p.sh. struktura dhe dinamika e tregut, niveli i konkurrencës, tendencat e zhvillimit të sektorit, perceptimi dhe nevojat e konsumatorëve). Kjo analizë duhet të bazohet kryesisht në gjendjen aktuale të tregut dhe të marrë në konsideratë faktorët që pritet të ndikojnë tregun në perspektive afat-mesme dhe afatgjate;
- b. kryejë një vlerësim të kuadrit rregullator të Shqipërisë për rregullimin ex-ante duke marrë në konsideratë kërkesat e kuadrit rregullator të BE dhe praktikën më të mira ndërkombëtare, dhe duke u fokusuar në:
 - procesin e analizave të tregut në lidhje me identifikimin e tregjeve, analizën për FNT, vendosjen/heqjen e masave rregullatore ;
 - rregullimi i aksesit dhe interkoneksionit
 - rregullimi i tarifave dhe kostot.
- c. japë rekomandime paraprake⁵ për përmirësimin e kuadrit rregullator që ka lidhje me zbatimin e masave rregullatore për FNT;
- d. hartojë Strategjinë e Zbatimit dhe Planin e Veprimit të Projektit për analizat e tregut. Ky plan duhet të vepronte si një udhëzim për zbatimin e përgjithshëm të projektit dhe duhet të përfshijë prioritetet kryesore, rezultatet e pritshme dhe skedarin kohor të implementimit të detyrave të projektit. Ky plan duhet të marrë në konsideratë kohën dhe rendin e analizave të mëparshme të tregut të zhvilluara nga AKEP, si dhe nevojat e tregut. Plani duhet t'u përmbahet kushteve reale dhe ngarkesës së punës. Koha për realizimin e projektit duhet të jetë realiste, që do të thotë se cilësia e realizimit të punëve nuk duhet të çenohet dhe njëkohësisht afatet e përcaktuara në projekt duhet të mos shkelen.

Në përgatitjen e Planit të Veprimit, Konsulenti duhet të marrë në konsideratë mundësinë e përfshirjes në një dokument analize tregu të disa tregjeve perkates, sipas praktikave më të mira në vendet e BE si edhe praktiken e ndjekur nga AKEP:

1. Tregjet me shumicë të telefonisë celulare (tregjet nr. 15-18 sipas rekomandimit 2003) dhe tregu me pakicë celulare (nr.8 sipas rregullores së AKEP).
2. Tregjet perkates me pakicë dhe me shumicë të telefonisë fikse (tregjet 1-6 dhe 8-10 Rekomandimi 2003)
3. Tregjet e linjave me qera me pakicë dhe me shumicë (tregjet nr. 7, 13 dhe 14)
4. Tregjet me shumicë broadband (tregjet nr 11 dhe 12)

Gjithashtu Konsulenti duhet të marrë në konsideratë se në bazë të nenit 35 të Ligjit 9918, kohezagjatja e periudhës së konsultimit publik për analizat e tregut është jo më pak se 60 ditë.

⁵ Rekomandime të tjera do të jepen gjatë gjithë fazave të projektit

Ne baze te analizave dhe vendimeve te AKEP per FNT, rendi i analizave qe do te kryhet nga konsulenti duhet te marre ne considerate rendin e mesiperme, dhe konsulenti duhet te respektoje afatet kryesore te pergjithshme te dhena ne **Grafikun e Ekzekutimit** dhe afatet e meposhteme qe AKEP duhet te respektoje ne vijim te vendim-marrjeve te meparshme te AKEP:

2. Analiza per tregun e terminimit ne rrjetet individuale celulare, tregu i akses/origjinimit te thirrjeve ne rrjete celulare duhet te publikohen per konsultim publik nga AKEP **brenda muajit Mars 2012;**
3. Analizat (analiza) finale dhe vendimet per FNT (pas konsultimit public) per tregjet e telefonise fikse, me pakice dhe me shumice (tregjet ne piken 2 me siper) duhet te publikohen nga AKEP **brenda muajit Korrik 2012.**

Konsulenti duhet te diskutoje dhe bjere dakort me AKEP per afatet e dorezimit te dokumentave te analizave gjate fazes se pergatijes se Strategjise se Zbatimit dhe Planit te Veprimit te Projektit , per te bere te mundur realizimin e afateve te mesiperme si dhe mundesine e kryerjes se analizes per sherbimet e Internetit brenda gajshtemujorit te pare 2012.

Outputi i kesaj faze do te jete Raporti Paraprak i strukturuar ne 4 pjese:

- Pjesa I: Analize e pergjithshme e faktoreve te rendesishem per rregullimin *ex-ante* (germa 'a' me siper)
- Pjesa II: Vleresim i kuadrit Rregullator per rregullimin *ex-ante* ne Shqiperi sipas germs 'b' me siper;
- Pjesa II: Rekomandime paraprake per permiresimin e kuadrit rregullator actual sipas germes 'c' me siper;
- Pjesa IV: Planifikimi Strategjik qe do te perfshije Strategjine e Zbatimit dhe Planin e Veprimit te Projektit sipas germes 'd' me siper;

Ne kete faze konsulenti do te duhet te bashkepunoje me strukturen perkatese te AKEP dhe lojtaret e tregut per te marre informacionin e nevojshme per hartimin e raportit. Cdo material ndihmes qe ka sherbyer per te hartuar raportin duhet ti bashkangjitet raportit.

Kjo faze nuk do te zgjase me shume se 6 jave nga data e fillimit te projektit (kick-off date: takimi I pare me AKEP pas nenshkrimet te kontrates). Ky afat perfshin depozitim nga Konsulenti te nje draft Raporti paraprak ne AKEP brenda 4 javesh nga data e fillimit te projektit, diskutime midis AKEP dhe konsulentit per komente, ndryshime dhe depozitim brenda 2 javesh te Raportit Paraprak Final. Raporti Paraprak Final do te miratohet nga Grupi i Supervizoreve te kontrates⁶ se AKEP me konsulentin, jo me vone se 1 jave nga marrja e tij.

Pas miratimit te Raportit Paraprak, konsulenti do te procedoje me zbatimin e detyrave te projektit sipas udhezimeve dhe planifikimit ne Strategjine e Zbatimit dhe Planin e Veprimit te Projektit.

⁶ Grupi i Supervizoreve te kontrates se lidhur midis AKEP dhe konsulentit (fitues) perbehet nga punonjes te AKEP. Perberja dhe detyrat e ketij grupi caktohen nga KD i AKEP dhe i behen te dituara konsulentit.

II- Pergatitja e pyetsoreve per analizat e tregut

Konsulenti do te duhet te njihet fillimisht me llojet e te dhenave te mbledhura periodikisht nga AKEP (publikuar ne rregulloren e te dhenave), te dhenat qe zoteron AKEP dhe ne baze te analizave qe do te kryhen te hartoje pyetsore me te dhena shtese, me qëllim që të mund të përftohen të gjitha të dhënat e nevojshme per kryerjen e analizave nga konsulenti, per tu plotesuar nga operatoret. Pyetsoret do te duhet te pergatiten ne format excel dhe te kene pershkrimet e nevojshme te treguesve. Keto pyetsore duhet te dergohen ne kohen e duhur ne AKEP, per tu dhene operateve kohen e nevojshme per plotesimin e tyre dhe per te mos u bere pengese per pergatitjen e dokumentave te analizave sipas afateve kohore rena dakort.

Konsulenti pritet te jape rekomandime dhe trajnime per stafin e AKEP per permiresimin e procesit te mbledhjes, perpunimit te te dhenave nga lojtaret e tregut.

III- Segmentimi i tregjeve perkates

Konsulenti do te duhet te beje percaktimin/ri-percaktimin e tregjeve perkates te justifikuar per nderhyrje ex-ante ne kushtet dhe rrethant e tregut shqiptar duke u bazuar:

1. ne listen e tregjeve te percaktuar ne nenin 3 te Rregullores se Analizes se Tregut te dhene me poshte:
 - 1) Tregun me pakice te aksesit ne rrjet telefonik publik nga vendodhje fikse per klientet familjare;
 - 2) Tregun me pakice te aksesit ne rrjet telefonik publik nga vendodhje fikse per klientet jo-familjare;
 - 3) Tregun me pakice per thirrje telefonike lokale dhe/ose kombetare te disponueshme per publikun te ofruar nga vendodhje fikse per klientet familjare.
 - 4) Tregun me pakice per sherbimet telefonike nderkombetare te disponueshme per publikun te ofruara nga vendodhje fikse per klientet familjare.
 - 5) Tregun me pakice per sherbimet lokale dhe/ose kombetare te disponueshme per publikun te ofruar nga vendodhje fikse per klientet jo-familjare.
 - 6) Tregun me pakice per sherbimet nderkombetare te disponueshme per publikun te ofruara nga vendodhje fikse per klientet jo-familjare.
 - 7) Tregun me pakice te minimumit te linjave me qera (i cili perfshin lloje te specifikuar te linjave me qira deri ne dhe perfshire 2Mb/sek)
 - 8) Tregun me pakice te aksesit dhe sherbimeve nepermjet rrjeteve mobile.
 - 9) Tregun me shumice te origjinimit te thirrjeve ne rrjetin telefonik publik te ofruara nga vendodhje fikse .
 - 10) Tregun me shumice te terminimit te thirrjeve per rrjete publike telefonike individuale te ofruara nga vendodhje fikse

- 11) Tregun me shumice te sherbimeve transite ne rrjetet telefonike publike fikse.
 - 12) Tregun me shumice te segmenteve terminuese te linjave me qera.
 - 13) Tregun me shumice te linjave kryesore (trunk) te linjave me qera.
 - 14) Tregun me shumice te aksesit ne infrastrukturen e rrjeteve fizike (perfshire aksesin e ndare te pjesshem ose te plote) nga vendodhje fikse.
 - 15) Tregun me shumice te aksesit broadband .
 - 16) Tregun me shumice te aksesit dhe origjinimin e thirrjeve ne rrjetet telefonike publike te levizshme
 - 17) Tregun me shumice te terminimit te thirrjeve ne rrjetet individuale te levizshme.
 - 18) Tregun kombetar me shumice per roamingun Nderkombetar ne rrjetet publike te levizshme.
2. Listen e tregjeve te rekomandimit te KE datë 11 shkurt 2003 (2003/311/EC)⁷;
 3. Listen e tregjeve te rekomadimit te KE datë 17 dhjetor 2007 (2007/879/EC)⁸
 4. Ne raste te justifikuara nga kushtet e vecanta kombetare tregje qe nuk jane pjese e listave te mesiperme dhe tregjet qe kane qene objekt analize nga AKEP si *terminimi i mesazheve SMS e rrjetet celulare*

Permbushja e ketij detyrimi do te perfshije:

- perkufizimin e detajuar te sherbimeve/produkteve qe jane pjese e te njejtit treg perkates (dimensioni i sherbimit) si edhe dimensionin gjeografik i tregut perkates duke marrë parasysh efektin e zevendesuesmerise ne anen e kerkeses dhe ofertes, duke perdorur parimin e monopolistit hipotetik.
- analizen nese secili prej tregjeve perkates te perkufizuar eshte ose jo i justifikueshem per nderhyrje ex-ante. Ne permbushjen e ketij detyrimi, Konsulenti do te duhet te analizoje nese karakteristikat e secilit treg perkates te shqyrtuar janë të tilla qe te justifikojne nderhyrjen ex-ante apo rregullim specifik sektorial. Ne kete analize Konsulenti do te duhet te perdore vecanerisht testin e tre kriterëve d.m.th nese nje treg ploteson tre kriteret e meposhteme :
 - o prezenca e barrierave te larta dhe jo-kalimtare te hyrjes ;
 - o nje strukture tregu e cila nuk ka tendence per te shkuar ne drejtimin te nje konkurrence efektive brenda afatit kohor perkates; dhe
 - o pamjaftueshmeria e ligjit te konkurrences per te adresuar ne menyre te pershtatshme deshtimin e tregut te marre ne shqyrtim

⁷ Rekomandimi i Komisionit, datë 11 shkurt 2003, për produktet dhe shërbimet përkatëse të tregut brenda sektorit të komunikimeve elektronike të rregullara *ex ante* në përputhje me Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit në një kuadër të përgjithshëm rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik (2003/311/EC, OJ L 114, 8.5.2003, p. 45)

⁸ Rekomandimi i Komisionit, datë 17 dhjetor 2007 për produktet dhe shërbimet përkatëse brenda sektorit të komunikimeve elektronike të rregulluara *ex ante* në përputhje me Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit në një kuadër të përgjithshëm rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik (2007/879/EC, OJ L 344, 28.12.2007, p. 65)

Në permbushjen e këtij detyrimi konsulenti do të duhet të marrë në konsideratë kushtet specifike ekzistuese dhe ato të prishme në tregun perkates në Shqipëri, bazuar edhe në përvijën dhe tendencat e këtij tregu në vende të tjera europiane që aplikojnë kuader rregullator të ngjashëm me Shqipërinë.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të Rregullores së analizës së tregut, perkufizimi i detajuar i tregjeve perkatese, dimensionimi gjeografik dhe i produktit/shërbimit, do të jenë pjesë e dokumentit të analizës së tregut. Njëkohësisht cdo ndryshim në perkufizimin e tregjeve perkates (dimensionimi i produktit/shërbimeve dhe gjeografik) dhe ndryshim statusi (nga treg I perkaktuar nga AKEP si I justifikueshëm për nderhyrje ex-ante në treg perkates jo të justifikueshëm për nderhyrje ex-ante), do të jenë pjesë e dokumentit të analizës së tregut. Pavarësisht se nga analiza e kryer nga AKEP në Mars 2010, tregu me pakicë celulare rezultoi si treg jo I justifikueshëm për nderhyrje ex-ante dhe nuk ka operatore me FNT në këtë treg, Konsulenti do të duhet të bëjë një vlerësim të tregut me pakicë celulare dhe aplikim të testit të tre kriterëve.

IV- Analiza për FNT

Në bazë të përfundimeve të arrituar e perkufizimin e tregjeve perkates për nderhyrje ex-ante, konsulenti do të kryejë analizën për FNT për të gjitha tregjet që janë të justifikuar për rregullim ex-ante. Konsulenti do të duhet të përdorë perkaktimet e ligjit 9918 të dhëna në kreun VI si dhe udhëzimet dhe rekomandimet e KE për analizat e tregjeve dhe FNT. Konsulenti duhet të bazohet në perkaktimin e nenit 33 të ligjit 9918 për perkufizimin e FNT,

Një sipërmarrës vlerësohet me fuqi të ndjeshme në treg nëse, i vetëm, apo së bashku me të tjerë, zotëron një pozitë të tillë ekonomike, që i mundëson një zgjerim të ndjeshëm, pavarësisht nga konkurrentët, klientët apo përdoruesit fundorë.

perkufizim i cili është pothuajse i njëjti me perkufizimin e Direktives Kuader të KE 2002, neni 14⁹ (EC 2002 Framework Directive).

Për perkaktimin e FNT, dominancë individuale apo e bashkuar, konsulenti do të duhet të bazohet në kriteret e perkaktuara në nenin 33 të ligjit 9918, i cili perkakton kriteret kryesore që duhet të merren në konsideratë për FNT (kriteret e vecanta për dominancë individuale dhe dominancë të bashkuar, si edhe në udhëzimin e KE (2002/C 165/03)¹⁰

Konsulenti do të duhet të perkaktojë të dhënat e nevojshme (nepermjet pyetjeve) për këtë analizë dhe të procesojë të dhënat e grumbulluara, analizojë dhe interpretojë gjetjet dhe të draftojë përfundimet.

Analiza e kryer për ekzistencën e konkurrencë efektive apo jo duhet të bazohet në kushtet aktuale të tregut të marrë në shqyrtim dhe duhet të marrë në konsideratë zhvillimet e prishme gjatë një periudhe të arsyeshme kohe,

⁹ *‘an undertaking shall be deemed to have significant market power if, either individually or jointly with others, it enjoys a position equivalent to dominance, that is to say a position of economic strength affording it the power to behave to an appreciable extent independently of competitors customers and ultimately consumers’*

¹⁰ *Udhëzuesi e komisionit për analizën e tregut dhe vlerësimin e FNT (2002/C 165/03) sipas kuadrit rregullator për komunikimet elektronike, rrjetet dhe shërbimet të komunikimit elektronik (në vijim referuar si Udhëzimi i KE)*

Përfundimi se në një treg përkatës ekiston konkurrenca efektive është ekuivalent me përfundimin se në treg nuk ka sipërmarrës me FNT, ndërsa kur analiza konkludon se një treg përkatës nuk është në konkurrencë efektive atëherë në këtë treg duhet të identifikohen një apo disa sipërmarrës me FNT.

V- Vendosja e masave rregulluese për FNT

Ne baze të përfundimeve për FNT, Konsulenti do të japë rekomandime dhe asistojë AKEP për vendosjen/mbajtjen/ndryshimin/heqjen e masave rregulluese/detyrimeve për FNT. Në plotësimin e kesaj detyre :

- Konsulenti do të duhet të identifikojë problemet që ekzistojnë në tregun e analizuar ku ka sipërmarrës me FNT dhe në baze të problemeve të evidentuara, të propozojë marrje të masave rregulluese apo detyrimeve për tu zbatuar nga sipërmarrësi/sipërmarrësit me FNT:
 - a. në rastet kur janë vendosur detyrime ex-ante, konsulenti do të rishikojë këto detyrime dhe do të rekomandojë që këto detyrime të mbahen/ndryshohen/hiqen ose të vendosen detyrime të reja ndaj sipërmarrësve me FNT, sipas rastit;
 - b. në rastet kur nuk janë vendosur detyrime, konsulenti do të rekomandojë vendosjen e detyrimeve të tilla për FNT.
 - c. në rastet kur ka pasur FNT dhe detyrime për FNT por analiza e kryer arrin në përfundimin se tregu nuk është me i justifikuar për nderhyrje ex-ante ose kur nuk ka sipërmarrës me FNT, atëherë konsulenti do të rekomandojë heqjen e detyrimeve të vendosura për FNT dhe kohën e berjes efektive të heqjes së detyrimeve.
- Konsulenti duhet të bazohet në parashikimet e Ligjit 9918 nën 34, sipas të cilit AKEP ka detyrimin që në rast të gjetjes së FNT në një treg përkatës të vendosë një disa apo të gjitha detyrimet e cëluara në nenet 39-45 dhe nën 56 të Ligjit si dhe të marrë në konsideratë dhe të referohet objektivave rregullatore të përcaktuara në Ligjin 9918 dhe të demonstrojë proporcionalitetin e masave rregulluese.
- Konsulenti duhet të marrë në konsideratë parashikimet e dokumentit : *ERG (06) 33, Revised ERG Common Position on the approach to Appropriate remedies in the ECNS regulatory framework, Final Version May 2006*, (ose ky dokument i perditesuar) si dhe të gjithë dokumentave të tjera të BEREC (ERG) dhe të EC, që janë relevant për tregun përkatës apo masat rregulluese të marra në shqyrtim.
- Konsulenti duhet të sigurojë që masat rregulluese të rekomandura të jenë mjaftueshmerisht të detajuara për të mundësuar sipërmarrësit me FNT zbatimin korrekt të tyre dhe AKEP dhe lojtarëve të tjerë kontrollin e zbatimit të tyre. Në detajimin e këtyre masave rregulluese konsulenti duhet të referohet dhe rregulloreve përkatëse të AKEP që janë të lidhura me zbatimin e masave rregulluese si p.sh Rregullorja e Aksesit dhe Interkoneksionit, dhe të japë rekomandime për përmirësimin e tyre nëse gjykohet e nevojshme.
- Në rastet kur konsulenti gjykon se justifikohet vendosja e detyrimeve të ndarjes së llogarive (neni 41 i ligjit 9918) dhe/ose sistemin të mbajtjes së llogarive (neni 45 i ligjit 9918), konsulenti duhet të japë detaje të zbatimit të këtyre detyrimeve për çdo treg përkatës/sipërmarrës me FNT ose nëse konsiderohet e nevojshme nëpërmjet një rregulloreje

te vecante sipas percaktimeve te Ligjit 9918 dhe duke marre ne konsiderate rekomandimet e BEREK (ERG) dhe KE per CA /AS.

- Konsulenti duhet te kryeje nje analize te impaktit rregulator te masave rregulluese te rekomanduara perfshire analize kosto-perfitim.
- Asistojte AKEP ne pergatitjen e vendimeve per FNT dhe masat rregulluese.

VI- Konsultimet publike

Konsulenti do te duhet te asistojte AKEP ne procesin e konsultimeve publike te te gjitha analizave te tregut qe do te kryhen me kete project. Per permbushjen e ketij detyrimi konsulenti do te pergatise per secilen analize tregu:

- Dokumentin e analizes se tregut per konsultim public,
- Komentet te permbledhura dhe pergjigje ndaj komenteve te paleve te interesuara
- Dokumentin final te analizes se tregut.

Konsulenti do te duhet te pergatisë dokumentet fillestare te mesiperme, në një formë të tillë që ato të jenë të përshtatshme për publikim.

VII- Struktura, formati i dokumentave te Analizave te Tregut dhe gjuha

I. Nje dokument i analizes se tregut (qe mund te permbaje nje apo me shume tregje te analizuar) per konsultim publik qe do te dorezohet nga Konsulenti duhet te permbaje:

1. Permbledhje Ekzekutive
2. Perkufizimin e tregut perkates:
dimensioni i sherbimeve dhe gjeografik;
aplikimi i testit te tre kritereve
3. Analizen per FNT (nuk perfshihet nese nga pika 2 rezulton se tregu perkates i marre ne shqyrtim nuk eshte i justifikueshem per nderhyrje ex-ante): shqyrtimin e secilit treg perkates per te analizuar konkurrencen ne keto tregje dhe nese ka operatore me fuqi te ndjeshme ne treg,
4. Problemet nga FNT
5. Detyrimet e propozuara per tu vendosur per operatorin apo operatoret me fuqi te ndjeshme ne treg. (nese nga pika 3 rezulton se tregu i analizuar eshte ne konkurrence efektive/nuk ka sipermarres me FNT, pikat 4 dhe 5 nuk perfshihen. Ne rast te heqjes se detyrimeve te meparshme, pefshihet nje kapitull 3: heqja e detyrimeve)
6. Projekt-vendim per FNT dhe masat rregulluese per secilin sipermarres me FNT. (nese gjen zbatim dhe eshte pjese e metodologjise se propozuar te Konsulentit)
7. Pyetje per konsultim public

II. Dokumentacioni final, pas kryerjes se konsultimit public, duhet te permabje:

1. Dokumentin final te analizes se tregut i cili duhet te kete te njejten structure si dokumenti I konsultimit public, pervec pikave 6 dhe 7 te cilat nuk perfshihen.
2. Komentet kryesore te derguara nga palet e interesuara ne konsultim public dhe pergjigjet per komentet. Keto mund te perfshihen ne nje document te perbashket ose ne dy dokumenta te vecante, si dhe mund per perfshihen edhe si aneks i Analizes finale (ose te integrohen ne Analizen finale sipas ceshtjeve te trajtuara).
3. Rekomandim per AKEP per formatin dhe permbajtjen e vendimit te KD per FNT dhe masat regulluese. Vendimet jane individuale per secilin operator me FNT.

III. Te gjitha raportet, dokumentet qe kerkohen per permbushjen e detyrave te projektit duhet te dergohen fillimisht ne forme elektronike nga Konsulentit ne adrese te Personit te Kontaktit te projektit per AKEP. AKEP dhe Konsulenti do te diskutojne komentet, amendimet ose plotesimet e draft-dokumentave. Dokumentat duhet te aprovohen nga Grupi i Supervizoreve te AKEP. Per dokumentet e cituara ne pikat I dhe II me siper do te jete e nevojshme komunikimi i Grupit te Supervizoreve me KD te AKEP dhe ne keto raste mund te jete e nevojshme komunikimi i Konsulentit me KD te AKEP me pjesmarrje ne takime direkte. Pas miratimit nga Grupi i Supervizoreve dokumentet e cituara ne pikat I dhe II me siper do te dergohen nga Konsulenti ne forme te pershtashme per publikim (format elektronik Word 2007 dhe pdf) dhe njekohesisht ne format te printuar.

IV. Dokumentacioni final (i rene dakort mes paleve) sipas pikave I (6 opsionale), II (1-2) dhe III me siper qe do te jete object publikimi/vendim-marrje e KD te AKEP¹¹, do te dergohen ne gjuhen shqip dhe anglisht. Raportet/dokumentat/informacionet e tjera te shkembyer midis Konsulentit dhe AKEP/lojtareve te tregut do te dergohen ne gjuhen shqip ose anglisht.

VII- Pronesia intelektuale dhe konfidencialiteti

Secili dhe te gjitha raportet, studimet, dokumentat etj, te pergatitur per realizimin e detyrave te ketij projekti jane prone intelektuale e AKEP. Asnje prej ketyre dokumentave apo te dhenave nuk duhet t'u shperndahet personave te trete pa miratimin paraprak te AKEP.

Konsulenti duhet t'i kushtoje vemendje te vecante konfidencialitetit te te dhenave dhe informacioneve te derguara nga AKEP dhe lojtaret e tregut.

VIII- Kerkesa te tjera

Konsulenti duhet ti jape AKEP cfaredo lloj asistence konsultuese gjate projektit, duke perfshire asistencen per:

- *Kontrollin dhe Menaxhimin e rrjedhes se procesit.* Konsulenti do t'i japë AKEP çdo lloj asistence për të kontrolluar ecurinë (rrjedhën) e procesit, për të kryer monitorimin periodik të zbatimit të tij. Gjithashtu Konsulenti do të japë asistencë profesionale për të organizuar dhe

¹¹ Sipas rregullave te funksionimit te AKEP publikimi i dokumenti te Analizes se tregut per Konsultim Public, publikimi i Versionit final te dokumentit te analizes se tregut (pas konsultimit public) dhe qendrimet ndaj komenteve, dhenia e statusit me FNT perfshire dhe masat rreguluese dhe cdo ndryshim/detajim I tyre kryhet me Vendim te Keshillit Drejtues te AKEP.

zhvilluar një bashkëpunimin tre-palësh ndërmjet Autoritetit Kontraktor, lojtarëve të tregut, si edhe do të japë asistencë për zgjidhjen e problemeve që lidhen me projektin.

- *Permiresimi i kuadrit rregullator për rregullimin ex-ante dhe rregulloret.* Konsulenti duhet të japë rekomandime për permiresimin e kuadrit rregullator dhe rregulloreve perkatëse që ka lidhje me zbatimin e masave rregullatore për FNT.
- *Realizimin e takimeve dhe konsultimeve me pjesëmarrësit e sektorit të komunikimeve elektronike.* Konsulenti, në prezencë të Autoritetit Kontraktor, duhet të mbajë takime periodike dhe konsultime me pjesëmarrësit kryesorë të sektorit të komunikimeve elektronike në lidhje me bashkëpunimin e paleve në dhenien e të dhenave të kerkuara si dhe për opinionet e tyre. Konsulenti duhet të përgatisë rezultatet e takimeve dhe konsultimeve.
- *Realizimin e konsultimeve dhe trajnimit të punonjësve të AKEP.* Konsulenti duhet të japë çdo asistencë të mundshme, rekomandim apo propozim për punonjësit e AKEP, të cilët do të marrin pjesë drejtpërdrejt në realizimin e projektit për analizat e tregut. Konsulenti duhet të përgatisë dhe zhvillojë trainimin e punonjësve AKEP gjatë të gjitha fazave të projektit në lidhje me:
 - ii. *Perkufizimin e tregut*
 - iii. *Analiza për FNT*
 - iv. *Vendosjen e masave rregulluese*
 - v. *Pergjigjet për konsultimet publike*Trajnimi i punonjësve të AKEP do të zhvillohet në ambientet e AKEP për çdo dokument analize (që mund të përmbajë 1 ose më shumë tregje të analizuar).
- *Trajtimin e ankimeve administrative.* Në bazë të legjislacionit shqiptar sipërmarresi ka të drejtë të bëjë ankim administrativ ndaj vendimit të AKEP brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit. Nëse do të ketë ankime në lidhje me vendimet e AKEP të marra bazuar në dokumentet e dorëzuar nga konsulenti, Konsulenti duhet të japë rekomandime për AKEP për trajtimin e tyre, në formën e përgjigjeve ndaj pretendimeve të sipërmarresit ankimues.

IX. Afati dhe Grafiku i Ekzekutimit të Sherbimeve

Afati i Përgjithshëm i realizimit të projektit do të jetë jo më shumë se 18 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët.

Për Grafikon e Ekzekutimit të Sherbimeve Shih shtojcën ___ të Dokumentit të Tenderit

X. Vendi dhe dorëzimi i dokumentave/sherbimeve:

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
Tirane